



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/239

Datë: 28.06.2018

Procesverbal

i mbledhjes se II (e dytë) të jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa
Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/68 datë:21.06.2018, e parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2019-2021.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/291 datë: 22.06.2018, e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për dhënie në shfrytëzim të pronës publike në fshatin Terpezë, KK.Malishevë për qëllime të infrastrukturës energjetike.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.05/257 datë:21.06.2018 e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm, për ndërtimin e Inkubatorit të Bizneseve në Malishevë.

Mbledhja u mbajt me datë:26.06.2018, në ora 10, morën pjesë 5 anëtarët e Kpf-së, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes e hapi mbledhjen e II të jashtëzakonshme, materialin e keni marrë i kemi edhe dy kërkesa para mbledhjes.

Raimonda Krasniqi: Unë po ju njoftoj se materialin e mbledhjes për sot nuk e kam pranuar, u njoftova prej kolegëve që kemi mbledhje sot, dyshoj që qëllimshëm nuk ma keni sjellë.

Rrahim Morina: Ju njoftoj se dy kërkesa ja kam drejtuar Kryetarit të Komunës nga Komiteti atë për KAB dhe kërkesën për vendosjen e trafos në Terpezë, tani drejtori i gjeodezisë na ka drejtuar një kërkesë por kjo është punë e kryetarit e jo e drejtorit aj duhet me na dhënë arsyetimin.

Muharrem Morina: Kërkesa e Kryetarit ka arsyetimin por edhe drejtori tani ka paraqit arsyetim.

Raimonda Krasniqi: Ketë arsyetim është dashtë ta jep kryetari i Komunës, pa kthyer ai përgjigje se di pse na keni thirr për këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: E ara kjo është jo seriozitet, e kote të merremi prapë me këtë kërkesë sepse është problem procedural, drejtori së ka këtë drejtë, kjo është injorim ndaj një institucioni sepse po kërkohet me dhënë tokë. Me kanë mu ba fjalë për KEK ata bëjnë edhe mihje dhe është diçka tjetër, por KEDS është kompani private e meja dhanë pa kompensim mundemi me kanë një ditë objekt hetimi. Të jemi më të kujdesshëm se KEDS s'mund me pas ndonjë tokë si aset.

Muharrem Morina: Çështja qysh edhe ju pe shihni është me shumë problem politik, diçka tjetër është se ju po mundohi me detyruar Kryetarin por ai me kuvend mund ta rregullojë këtë kërkesë. Ju keni te drejt por Kuvendi është ai që vendosë për kohen, çmimin por aj ka kërkuar meja dhanë në shfrytëzim, prona nuk i jepet në posedim.

Hashim Vrenezi: Edhe sot është e pa logjikshme me diskutu e kur mungon personi përgjegjës, edhe pika e dytë nuk bën të hyn në rend dite, e për te tretën mundemi ta debatojmë sepse s'kemi shumë informata, Raimonda se ka marrë materialin dhe është mirë të na dërgoni të shtëpia, pasi që me lanë neper lokale mundet dikush edhe ta merr dhe na humb materiali.

Rrahim Morina: Unë jam që edhe KAB edhe kërkesa për Terpezë të shkojnë në Kuvend, aty të debatohet me pa edhe qytetaret ku qëndron problemi.

Raimonda Krasniqi: Unë s'jam kjo kërkesë të shkoj në Kuvend, sepse unë jam në gjendje ta jap kontributin për fshatin Terpezë, por tani kryetari po donë më i ndihmu dikujt që i ka ndihmuar në zgjedhje e aty ku po kërkohet vendosja e trafos nuk ka asnjë shtëpi.

Rrahim Morina: I kemi dy kërkesa një nga Alban Mazreku për ndërrim destinim të tokës dhe një kërkesë nga drejtoresha e Kulturës për mbajtjen e festivalit Oda e Llapushës.

Alban Krasniqi: E kemi edhe një kërkesa nga një qytetar i fshatit Damanek, ajo kërkesë me pëlqeu dhe është mirë me shqyrtuar.

Rrahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës me këto kërkesa shtesë?

Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/68 datë:21.06.2018, e parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2019-2021.

Drejtori i Financave Valon Mazreku: Ju kemi paraqitur Kab-in me projeksionet buxhetore, kurse në qarkoren e dytë do të futen edhe projektet kapitale. Janë te cekura grantet nga Qeveria, pagat në Arsim, tani është përfshi edhe tatimi nga toka.

Alban Krasniqi: Qysh e keni paraparë këtë rritje?

Hashim Vrenezi: Sa janë të hyrat vetanake në vitin 2018.

Valon Mazreku: Mbi 1 milion të realizuara mbi 500 mijë, por është një trend i rritjes.

Alban Krasniqi: Ty pas për bazë pa aftësinë e Komunës në vjeljen e të hyrave hiqi 110 mijë menjëherë.

Valon Mazreku: Mef këtë e përcakton qysh tju vjen ma lehtë, ne kemi kërkuar rritjen e mallrave dhe shërbimeve, Komuna por nuk na kanë përfillur kërkesën.

Hashim Vrenezi: Çfarë të hyra kemi pas nga qeraja, sepse të hyrat rriten nga qeratë.

Valon Mazreku: Për këtë nuk e di saktë.

Alban Krasniqi: Kjo tregon që Kab-it i mungon pjesa e qartë se kah vijnë të hyrat, kemi mungesë të informacioneve bazë. Ty krejt drejtoritë është dashtë me t'i sjellë të dhënat.

Hashim Vrenezi: Kjo është veç një përshkrim i Kab-it nga 2017, por duhet me kanë me i specifikuar.

Rrahim Morina: Të hyrat në Arsim mungojnë sepse është zë buxhetor.

Valon Mazreku: Unë nuk po them se gjithçka është ok, por ka shënime për projeksionet.

Alban Krasniqi: Në bazë të këtyre limitëve ku kanë shkuar mjetet, qeveria përshebull në shëndetësi të korniza e qeverise është përmend edhe komunat çka ka me investuar, pse te pagat nuk bëhet zë buxhetor, por ceken vetëm mallra dhe shërbime.

Rrahim Morina: Te zyra e kryesuesit s'keni parapa shpenzime.

Valon Mazreku: Nga mallrat dhe shërbimet lejohet pagesa e komisioneve.

Hashim Vrenezi: Ne po kërkojmë kategorizim e jo kështu grupizim i shpenzimeve psh. Ceket veç rruga në fshat e në prokurim hiqet, sepse i qojnë metrat për asfalt aty ku kanë marrë vota, shembull e kemi vetëm lagja Bekolli në Marali, a është shkelje nëse nuk bëhet shpallja sipas buxhetit që është miratuar.

Muharrem Morina: Këto kanë ndodhur por kryetari ka kerku të eliminohen këto dhe projektet të paraqiten edhe në orto foto.

Valon Mazreku: Në qarkoren e dyte krejt këto kanë mu specifikuar, neper fshatra kemi me mbajt debate publike me pa ku i kanë hallet qytetaret. Mjetet janë nda sipas secilit dikaster, subvencionet kryetari i ndan në bazë të kërkesave, të hyrat në Kuvend janë paraparë pagat si dhe dy trupat e Kuvendit.

Alban Krasniqi: Pse stafi i Kuvendit zero duhet të parashihet stafi në Kuvend.

Muharrem Morina: Është organografi dhe tani katalogu që është në proces të miratimin që e rregullon këtë fushë, pastaj ligji i pagave.

Valon Mazreku: Kryetari e bënë lëvizjen dhe ricaktimin e punëtorëve.

Rrahim Morina: Për realizimin e punëve edhe Kryetari edhe nënkryetari i kanë veturat në dispozicion kurse kryesuesi me pas ndonjë takim zyrtar nuk e ka këtë të drejtë te këtë një veturë. Buxheti i Kuvendit duhet të behet 50 mijë euro.

Alban Krasniqi: Të parashihet blerja e një veture për Kuvendin, sepse kushtet e punës janë çnjerëzore e jo në mi prit qytetaret nëpër kafe por mi pas kushtet për punë mi pas zyret në si grupe politike. Te Muzeu ka mundësi sepse atje janë disa zyre që munden mu shfrytëzuar. Buxheti për zyrën e Kuvendit duhet të bëhet 50 mijë euro, duhet të behet rregullimi i sallës të pajiset me teleprezencë, zyra e kryesuesit, paisja e anëtarëve me kartela.

Pastaj të zyra për barazi gjinore të bëhet buxheti 5 mijë euro, sepse ska mjete për realizimin e aktiviteteve. A e dini se zjarrfikësit nuk kanë kamjon. Raporti i Kryetari dhe Kab të Bujqësia nuk ka ndonjë orientim se çka do të behet, çka a mbërri deri tani, sa tokë punë janë etj.

Valon Mazreku: Këtu janë vetëm kufijtë edhe të shëndetësia ceken laboratorë, materiale, dru, higjiena. Te arsimi ceken 1 mijë të punësuar, por kemi 10 mijë euro minus në Arsim.

Muharrem Morina: Nga praktika në mallra e shërbime mund të ketë lëvizje problemi ka me qenë te projektet kapitale, sepse tani duhet dëgjime publike sepse tani është praktike edhe buxhetimi me pjesëmarrje.

Alban Krasniqi: Duhet mi tregu edhe qytetarit se pa ta rregullu kanalizimin nuk ta shtroj asfaltin. Hashim Vrenezi: Të kultura janë cek 174 mijë por nuk janë te specifikuara.

Valon Mazreku: Këtu hyjnë festivali Oda e Llapushës, 16 Qershori e disa festa tjera.

Alban Krasniqi: Kur mbahet një festë ose organizohet një koncert dhe merret Meda me këndu ato parë është si me i gjuajt në lloç. Këtu thotë se Kab duhet të behet në harmoni me Planin zhvillimore atëherë duhet me kanë në përputhje, sepse ka kanalizime që derdhen neper livadhe e janë në shpërpushje me atë plan.

Valon Mazreku: Në një takim me Osbe është diskutuar qysh me ba një unifikim sa i përket këtyre kornizave buxhetore ose Kab.

Hashim Vrenezi: Ky dokument mundet mu ndryshuar me një aneks dokument për secilën drejtori përkatëse.

Valon Mazreku: Në qarkoren e dytë buxhetore mundet mu përfshi këto ndryshime.

Rrahim Morina: Nëse këto ndryshime bëhen atëherë të Enjten mundemi meju shpërnda Kuvendit për mbledhjen e se Premtes.

A jeni ta rekomandojmë për Kuvend me këto kërkesa nga Kpf? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/291 datë: 22.06.2018, e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për dhënie në shfrytëzim të pronës publike në fshatin Terpezë, KK.Malishevë për qëllime të infrastrukturës energjetike.

Rrahim Morina: Debatimi për këtë kërkesë u krye në fillim, kush jeni këtë kërkesë ta kthejmë mbrapa në mungesë arsyetimi? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.05/257 datë:21.06.2018 e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm, për ndërtimin e Inkubatorit të Bizneseve në Malishevë.

Muharrem Morina: Këtë kërkesë e ka sjellë drejtori i Urbanizmit në Malishevë, ndërtimin e bënë Ministria, prej Kuvendit është kërkuar vetëm themelimi i Inkubatorit por që duhet vendim. Këtu ceket edhe në Udhëzim Administrativ nga MTI neni 6 paragrafi 1.4 nëse ju doni ne e bëjmë kërkesën për kuvend.

Alban Krasniqi: Po kërkohet të themelohet inkubatori i bizneseve por cili është qëllimi, interesi çka përfiton Malisheva, apo veç po kërkohet mu ndertu një objekt si ky i Komunës.

Rrahim Morina: nëse pajtoheni e shtyjme në mungesë të dokumentacionit? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.12/90 datë:25.06.2018 e drejtorisë për Kulturë për festivalin Oda e Llapushës.

Besa Kryeziu: Kam bërë një kërkesë dhe kërkoj te futet në kuvend për organizimin e festivalit folklorik, kemi mbështetje edhe nga Ministria e Diasporës për pritjen e bashkatdhetarëve, panairi artizanal, organizmi i sofrës me bashkatdhetarë. Ka me kanë një ekskursion me fëmijët e bashkatdhetarëve në disa vende, e këtë kërkesën që ceke Alban të atij qytetarit mendoj se tani është vonë, pastaj është kuizi i diturisë me fëmijët e bashkatdhetarëve i përkrahur nga një institut Leds me 2080 euro, sofa me bashkatdhetar ushqim, pike 800 euro participim nga Komuna.

Hashim Vrenezi: A ka me kanë njoftimi publik.

Besa Kryeziu: Po do të behet njoftimi publik.

Alban Krasniqi: Është mirë me ba një grup punues me shpallë javën e Diasporës për çdo vit me kanë i angazhuar edhe Komiteti i Diasporës, dhe ky organizim me kanë i parvjetshëm.

Rrahim Morina: Ceket në kërkesë 200 euro çmimi për jurinë a mos është shumë?

Besa Kryeziu: Jo sepse ka punë se ka edhe konkurse, ka me pas konkurrenca dhe nga OJQ.

Hashim Vrenezi: Këta që përzgjidhen a bëhen pastaj publike.

Alban Krasniqi: Çmimi te zerimi dhe ndriçimi është shumë i lartë.

Rrahim Morina: Ajo kërkesa e atij qytetaret mundet të inkorporohet ne kërkesën e Drejtorisë për Kulturë.


Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

-Kërkesa nr.02/234 datë: 25.06.2018 e Alban Mazrekut për ndërrim te destinimit të tokës

Rrahim Morina: Kërkesa është e kompletuar, kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Mbledhja përfundoi ne ora 13.30 min.

Procesmbajtësi
Naim Avdijaj Jur. i Dip.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

